



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

RAPORT

**MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES
PËR VEPRIMTARINË E VITIT 2012**

HYRJJE

Kontrolli i sigurimit të cilësisë, si një proces i cili synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese në zbatim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit, ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së KLSH-së, siç edhe është reflektuar në Planin Strategjik të Zhvillimit 2009-2012 dhe në programet afatmesme e vjetore të aktivitetit të këtij institucioni.

Sigurimi i cilësisë, bazuar në standardet kombëtare e ndërkombëtare, është konsideruar si kërkesë e domosdoshme për të identifikuar objektivist mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat efektive që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e punës audituese dhe njëkohësisht t'i shërbejë ligjvënësit, ekzekutivit dhe publikut për t'u njohur me transparencën e përdorimit dhe administrimit të fondeve publike.

Referuar kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, procesi i sigurimit të cilësisë së auditimeve të kryera nga KLSH, konsiderohet si një proces i bashkërenduar, ku në radhë të parë kërkohet që KLSH të miratojë praktikrat dhe procedurat e nevojshme për t'u siguruar që detyrat e auditimit janë kryer në shkallën e duhur të cilësisë, dhe në radhë të dytë, që KLSH të kryejë rishqyrtimet e sigurimit të cilësisë të auditimeve në një shkallë më të lartë, duke vendosur më pas që këto praktika dhe procedura të jenë të detyrueshme për zbatim në mënyrë që të ushtrohet efekti i duhur në kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë në të ardhmen.

Për arritjen e objektivit kryesor, kryerjen e auditimeve në cilësinë më të lartë të mundshme, KLSH ka synuar krijimin e një sistemi të menaxhimit të plotë të cilësisë, i cili të mbulojë të gjithë sferën e veprimtarisë së tij. Për këtë arsye, janë hartuar dhe zhvilluar në vazhdimësi, politika, sisteme, procedura, instrumente dhe masa të tjera të përshtatshme për të siguruar që KLSH është organizuar në mënyrë kompetente për të prodhuar punë e raporte të një cilësie sa më të lartë dhe të besueshme për ligjvënësit e taksapaguesit.

Vendosja dhe ndjekja me përgjegjësi e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, ka krijuar një siguri të arsyeshme që KLSH dhe personeli i këtij institucioni, i kryejnë detyrat e tyre me besueshmëri e efektivitet të lartë në përputhje me detyrimet Kushtetuese e ligjore, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH, Kodin Etik, praktikrat bashkëkohore të auditimit të institucioneve homologe, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

II. KONSTATIME TË PËRGJITHËSHME

Për realizimin e objektivit kryesor të KLSH në kryerjen e auditimeve të një cilësie sa më të lartë, është thelbësore ekzistenca e një sistemi të menaxhimit të plotë të cilësisë, i cili të mbulojë të gjitha drejtimet e veprimtarisë së institucionit.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, si koncept i përgjithshëm përfshin:

- A. Menaxhimin e cilësisë në nivel institucional;
- B. Sistemin dhe procedurat e kontrollit të cilësisë (shqyrtime të “nxehta”); dhe
- C. Procesin e sigurimit të cilësisë (shqyrtime të “ftohta”).

Niveli i ndjekjes dhe zbatimit, nga hallkat përkatëse të institucionit, të elementeve të mësipërm përbërës të këtij sistemi, ka patur një ndikim të rëndësishëm në shkallën e realizimit faktik të cilësisë të punës audituese.

A. Menaxhimi i Cilësisë në nivel institucional

Duke patur parasysh elementët përbërës kryesorë të menaxhimit të cilësisë në nivel institucional (politika dhe strategjia e cilësisë, përkushtimi i drejtuesve, metodologjia, mbështetja me IT, menaxhimi i burimeve njerëzore, marrëdhëniet jashtëinstitucionale, etj.), drejtuesit e institucionit i kanë kushtuar vëmendje parësore këtyre elementëve, duke i vlerësuar si një proces i rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së punës audituese.

Gjithsesi, ekziston vazhdimisht nevoja për përpjekje më të mëdha në këtë drejtim, sidomos në përsosjen e politikave, objektivave e instrumenteve zbatues, dhe më konkretisht në:

1. Krijimin e një mjedisi pune favorizues për profesionalizmin.

Për sigurimin e cilësisë së punës audituese, janë ndërmarrë masa konkrete tekniko-organizative, të cilat janë në përputhje Standardet e Përgjithshme të INTOSAI-t, ku i kërkohet Institucioneve Supreme të Auditimit të përgatisin manuale dhe udhëzime si dhe rregullore të tjera për drejtimin e auditimit.

Në zbatim të kërkesave të mësipërme, janë reflektuar në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së një sërë politikash, sistemesh dhe instrumentash të përshtatshme, shoqëruar dhe me Dokumentet e Formularët Standard (miratuar me vendim të Kryetarit nr. 53, datë 16.04.2012), Manualët e Auditimit Financiar e atij të Performancës dhe në urdhëra e udhëzime të veçanta, në të cilat pasqyrohen aspektet procedurale që duhet të ndiqen gjatë programimit, ushtrimit dhe raportimit të rezultateve të auditimit, në përputhje dhe në zbatim të të drejtave e detyrimeve Kushtetuese dhe ligjore të KLSH.

Hartimi i Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së, u diktua nga fakti se rregullat dhe udhëzimet në përdorim, të hartuara në vitet 2005 -2006, për shkak dhe të ndryshimeve ligjore në fushat e administrimit të pronës e fondeve publike, kishin humbur vlerën dhe efektivitetin e zbatimit të tyre në praktik.



KONTROLLI I LARTË I SHITIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

2. Menaxhimi e burimeve njerëzore.

Në vlerësim të rëndësishë që parashtron menaxhimi i drejtë dhe racional i burimeve njerëzore, për sigurimin e cilësisë së punës audituese, duke patur parasysh dhe faktin që politikat për burimet njerëzore duhet të mbështesin mbajtjen dhe zhvillimin e një stafi të kualifikuar, kompetent dhe të aftë për të zbatuar planet e auditimit në mënyrë sa më të efektshme, KLSH për vitin 2012, ka ndërmarrë dhe zbatuar politika jo vetëm korrekte, por edhe të efektshme, në drejtim të rekrutimit e një personeli me eksperiencë dhe kualifikim të duhur arsimor, për kryerjen me cilësi e kompetencë të detyrës audituese.

Mangësitë e vërejtura në vitin 2011, ku rekrutimi i shumë punonjësve ishte bërë me kontrata të përkohshme pune dhe të cilët rezultuan me vlerësime të dobëta në testimin profesional, konfirmon faktin se rekrutimi jo mbi baza transparente dhe konkurrence, ofron staf me cilësi të dobët, gjë e cila dëmton imazhin, besueshmërinë dhe efektivitetin e punës së institucionit.

Për vitin 2012, në reflektim të mangësive dhe problematikës së mësipërme, procedurat për plotësimin e vendeve të lira të punës, filluan me shpalljen e rregullt të tyre sipas dispozitave përkatëse ligjore, në mënyrë që rekrutimi i punonjësve në KLSH të realizohej nëpërmjet konkurrimit me anë të testimit të njohurive dhe përzgjedhjes mbi kriteret objektive.

Një faktor i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së punës audituese, ka qenë edhe zhvillimi i pandërprerë i trajnimeve të stafit auditues të KLSH, me përvojat e praktikave bashkëkohore të auditimit. Në ndryshim nga vitet e kaluara, ky faktor është vlerësuar maksimalisht si një nevojë e domosdoshme dhe emergjente në ngritjen e nivelit profesional të punonjësve, duke përcaktuar si objektiv realizimin e 10 ditëve trajnim në vit për audituesit e vjetër dhe 25 ditëve trajnim në vit për audituesit e rinj, objektiv i cili jo vetëm që u arrit të realizohej por edhe u tejkalua.

Një rëndësi e veçantë për këtë vit, i është kushtuar edhe trajnimeve të specializuara në institucionet homologe të auditimit përse i përket auditimeve të performancës, në funksion të përparësisë dhe peshës që këto auditime do të kenë në veprimtarinë e ardhshme audituese të KLSH.

Evidentimi i aftësive profesionale për çdo auditues, të realizuar çdo fund viti nga ana e Departamenteve të Auditimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë, i ka shërbyer së tepërmi programimit të nevojave për trajnim të audituesve, brenda dhe jashtë institucionit, siç dhe ishte parashikuar në objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit të KLSH për periudhën 2009 - 2012, mbi bazën e të cilit u hartua dhe u zbatua edhe programi i trajnimeve për vitin 2012.

Bazuar në programin e trajnimeve për vitin 2012, janë realizuar 19 tema të ndryshme trajnimi, tematika e të cilave ka qenë si më poshtë:

- Auditimi financiar.
- Auditimi i performancës.
- Përditësimi i legjisllacionit, njohja, përvetësimi dhe azhurnimi i audituesve me ligjet e reja.
- Parimet, objektivat dhe kufizimet e Kontrollit të brendshëm.
- Programet financiare, Financa 5 ose Alpha.
- Standardet e auditimit – Planifikimi. Njohja e veprimtarisë së institucioneve dhe Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të brendshëm.
- Kontrolli i brendshëm Financiar Publik.
- Njohja me teknologjinë e informacionit (Office 2003 dhe 2007, përdorimi i e-mailit të brendshëm dhe i antivirusit), si dhe njohja me programin IDEA.
- Vlerësimi i riskut dhe materialitetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

- Prokurimi Publik (njohja me legjislacionin e prokurimit publik, me përdorimin elektronik të prokurimeve publike, konçensionet, si dhe marrëveshjet kuadër dhe kriteret për fitimin e kontratave.
- Urbanistika, azhornimi me ligjet për urbanistikën.
- Auditimi i buxhetit të shtetit, ku trajtohen marrëdhëniet e KLSH-së me parlamentin për raportimin e buxhetit të shtetit, të ardhurat, shpenzimet, defiçiti i borxhit dhe borxhi publik.
- Azhornimi me rregullat e brendshme të KLSH, standardet e raportimit të SAI-ve sipas INTOSAI-it dhe Kodi Etik i KLSH-së.
- Auditimi i regjistrimit të pasurive të pa luajtshme dhe administrimi i aseteve të paluajtshme.
- Auditimi i projekteve me financime të huaja.
- Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare.
- Auditimim i vlerësimit mjedisor.
- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Informacion i përgjithshëm për audituesit rreth SNKSP-ve (SNKSP 1, SNKSP 17, SNKSP 24).
- Korrupsioni dhe Mashtrimi.
- Tatimi dhe Taksa. Kuptimi i tatimit, shmangia nga pagimi i tatimit, sistemi tatimor në RSH, organet tatimore, si dhe ndryshimi ndërmjet tatimit dhe taksës.

Përveç trajnimeve të mësipërme, gjatë vitit 2012 janë realizuar edhe një sërë trajnimesh të veçanta me punonjësit e porsa rekrutuar në KLSH, në të cilat janë trajtuar temat e mëposhtme:

- Njohjen me institucionin (çfarë është KLSH, baza ligjore, objektivi, misioni, vizioni, veprimtaria kontrolluese, llojet e kontroleve që kryen, dokumentet standarde, etj)
- Njohuritë për auditimin financiar (çfarë është auditimi financiar, tiparet dalluese të tij dhe dokumentet standarde).
- Komunikimi i brendshëm në KLSH.
- E drejta kushtetuese, Kushtetuta, Parimet Themelore.
- Standardet e INTOSAI-t, çfarë është INTOSAI.
- Njohja me Auditimin Financiar. Çfarë është auditimi financiar, tiparet dalluese të këtij auditimi dhe dokumentet standarde.
- Njohja me auditimin e performancës. Çfarë është auditimi i performancës, çfarë janë 3 E-të (efiçenca, ekonomiciteti, efektiviteti), cilat janë dokumentet standarde të këtij lloji auditimi, si dhe ndryshimi midis auditimit financiar dhe të performancës.
- Fazat e auditimit, analiza e riskut dhe materialitetit. Cilat janë fazat e auditimit. Çfarë është risku dhe në sa tipe i ndajmë ato. Çfarë është materialiteti.
- Llojet e shoqërive tregtare.
- Akti administrativ.
- Rregullimi i marrëdhënieve të punës.

Gjatë vitit 2012, është treguar një kujdes i veçantë në zhvillimin e karrierës profesionale brenda institucionit, faktor ky që ka ndikuar së tepërmi në rritjen e cilësisë së drejtimit dhe të punës audituese. Krahasuar me vitet e tjera, zhvillimi profesional i audituesve dhe përparimi i tyre në karrierë, u realizua nëpërmjet sistemit të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive individuale, testimit të njohurive profesionale, si dhe konkurrimit transparent për pozicionin e punës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

Në zbatim të kërkesave dhe standardeve të parashikuara në Kodin e Etikës dhe Rregulloren e KLSH-së, gjatë vitit 2012 janë dhënë disa masa disiplinore ndaj punonjësve të institucionit të cilët kanë abuzuar apo i kanë shkelur ato.

Duke e konsideruar punësimin në KLSH si besim të publikut në ndershmërinë, integritetin, besueshmërinë dhe profesionalizmin e punonjësve të këtij institucioni, një vëmendje e veçantë i është kushtuar forcimit dhe zhvillimit të vlerave të mësipërme si dhe promovimit të punës në grup, respektimit të diversiteteve, përballimit të sfidave e përgjegjësive, si dhe vlerësimit të të tretëve për veprimtarinë e KLSH.

Në mbështetje të këtyre kërkesave, në nenin 12 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH, miratuar në vitin 2012, është parashikuar trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, në mënyrë që audituesit dhe ekspertët e jashtëm të KLSH të ndërgjegjësohen për zbatimin e programit të auditimit, shmangien e konfliktit të interesit ose të faktorëve të tjerë që mund të pengojnë audituesit në kryerjen e detyrave me kompetencë e efektivitet si dhe të rrisin efecensën e punës së tyre për të arritur një cilësi sa më të lartë në punën audituese.

3. Menaxhimi i rrezikut institucional.

Duke patur parasysh që KLSH, në përmbushje të veprimtarisë dhe objektivave të tij audituese, përballet me disa rreziqe të karakterit institucional, gjatë vitit 2012 janë ndërmarrë nisma për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve, duke evidentuar dobësitë në planifikimin strategjik e vjetor të auditimeve prioritare, burimet e pa mjaftueshme njerëzore, teknikat e praktikat e papërshtatshme të auditimit, dobësitë e raporteve të auditimit, si dhe ndikimet e ndryshme politike që mund të çenojnë pavarësinë e institucionit.

Gjatë vitit 2012, KLSH është përballur me një situatë në të cilën nevoja për kryerjen e auditimeve tejkalohet nga mundësitë reale në burime njerëzore e materiale, që ka në dispozicion ky institucion.

Duke marrë në konsideratë këtë fakt dhe me qëllimin e arritjes së një niveli sa më të lartë të sigurimit të cilësisë, një rëndësi e veçantë i është kushtuar shfrytëzimit sa më racional të burimeve në dispozicion, duke programuar e kryer auditime në subjektet që paraqesin një nivel të lartë të riskut.

Niveli i riskut për subjektet e audituara, është përcaktuar duke grumbulluar, seleksionuar dhe studiuar të dhënat e marra ndër vite për çdo subjekt auditimi dhe që kanë të bëjnë me llojin dhe volumin e veprimtarisë së subjektit, periudhën e kontrolluar, rezultatet e mëparshme të auditimit, zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kaluar, arsyet e auditimit, si dhe duke patur parasysh vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit që ato mbartin në përdorimin e fondeve publike.

Gjithashtu lidhur me zhvillimin e strategjisë së planifikimit të auditimit u shfrytëzuan dhe u aplikuan njohuritë e përftuara dhe përvoja e NAO të Britanisë së Madhe. Për këtë qëllim u hartuan dhe përpunuan tre mjete të planifikimit strategjik dhe u përdorën e shfrytëzuan formularët standard, në të cilët sipas një vlerësimi me pikë për çdo kriter përzgjedhje nga 0-5, nga tërësia e auditimeve të parashikuara, u përzgjedhën auditimet për vitin 2012, për t'i audituar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të përshtatura nga KLSH-ja dhe praktikat më të mira Europiane, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë, informacion sa më të plotë mbi përdorimin e fondeve publike.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

4. Komunikimi dhe marrëdhëniet me të tretët

Drejtuesit e institucionit i kanë kushtuar vëmendjen e duhur vendosjes, ruajtjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve efektive me të tretët, si element i rëndësishëm i sistemit të menaxhimit të cilësisë. Në zbatim të Udhëzuesit mbi Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë, në kuadrin e menaxhimit institucional, rëndësi i është kushtuar zhvillimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale të KLSH, siç është vendosja dhe mbajtja e marrëdhënieve sa më të mira e korrekte me Kuvendin dhe Komisionet e tij.

a. Për stafin drejtues dhe kontrollues të KLSH-së për vitin 2012, inkurajuese, por në të njëjtën kohë detyrim e përgjegjësi për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të punës kontrolluese, kanë qenë konkluzionet e shprehura në Rezolutën e Kuvendit datë 26.04.2012, për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011. Me këtë rezolutë, Kuvendi krahas vlerësimit të veprimtarisë kontrolluese, ka kërkuar që për vitin 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit të intensivikojë punën në këto drejtime:

- Kryerjen e kontroleve ndaj përdorimit të fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm cilësi dhe efektivitet të lartë.
- Rritjen e efikasitetit të veprimtarisë audituese, nëpërmjet fuqizimit të auditimit financiar dhe hedhjes së hapave më të shpejtë, drejt auditimit të performancës.
- Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikat më të mira të vendeve të tjera.
- Harmonizimin e veprimtarisë së kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm, si dhe zhvillimin e forcimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Zhvillimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë përparësi zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë trajnuese.
- Zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivelet bashkëkohore, si dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë.
- Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanarisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit.
- Rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.
- Rritjen e transparencës ndaj medias dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e bashkëpunimit me botën akademike.

Vlerësimet për veprimtarinë kontrolluese dhe kërkesat e Kuvendit ndaj organit të KLSH-së, të cilat konfirmojnë arritjet dhe përcaktojnë detyrat në drejtim të realizimit të misionit, vizionit, detyrimeve kushtetuese e ligjore të KLSH-së, janë patur parasysh e zhvilluar gjatë vitit 2012 për arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë.

b. Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, për të rritur një shkallë më të lartë luftën kundër korrupsionit, të rëndësishme kanë qenë marrëveshjet e bashkëpunimit me: Institutin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Autoritetin e Konkurrencës dhe Ministrinë e Financave, Agjencinë e Prokurimit Publik, Departamentin e Administratës Publike, Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe Institutit “G&G Group”. Duke qenë se KLSH është në proces reformimi, këto marrëveshje janë të rëndësishme për institucionin, sepse mundësojnë bashkëpunimin me partnerë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

profesional që do ta ndihmojnë për t'u orientuar më mirë në sfidat e ardhshme, siç janë modernizimi i institucionit, si dhe thellimi i luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij.

Duke vlerësuar nivelin jo të kënaqshëm të marrëdhënieve me organin e akuzës, ku dhe numri i kallëzimeve penale nga KLSH vitin e kaluar kishte një rënie të dukshme, me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, në respektim të pavarësisë së institucioneve, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit, e cila pati ndikime pozitive, pasi kallëzimet tona këtë vit u vlerësuan nga ana e Prokurorisë.

c. Të rëndësishme në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional me të tretët kanë qenë edhe marrëveshjet e lidhura në muajin prill 2012 me shoqërinë civile, me gjashtë organizata jo fitimprurëse më të spikatura në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës, siç janë: Lëvizja Alternative Civile, Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë, Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Transparency International në Shqipëri dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri. Marrëveshjet u lidhën në zbatim të parimeve e orientimeve të përcaktuara në Standardet e Auditimit të INTOSAI-t, se eksperiencia e përbashkët u shërben të gjithëve dhe synojnë kontribute dhe aktivitete të përbashkëta të KLSH-së dhe shoqatave, si vrojtme, prognoza dhe studime të përbashkëta, pjesëmarrje reciproke në seminare, simpoziume, konferenca, në luftën kundër korrupsionit, mundësisht parandalimin e tij, luftë e cila mund të ketë sukses vetëm me punë të përbashkët në sistem, si dhe rritjen e transparencës së institucioneve publike. Për KLSH-në është e rëndësishme të shfrytëzohet eksperiencia dhe ekspertiza e organizatave të shoqërisë civile për realizimin e analizës së riskut në përzgjedhjen e auditimeve të prioritetit të lartë, si dhe në hartimin e raporteve e rekomandimeve për përmirësimin e performancës të institucioneve të audituara.

ç. Në drejtim të përmirësimit të standardeve të auditimit me moton e INTOSAI-t, se eksperiencia e përbashkët i shërben të gjithëve, në krahasim me vitet e kaluara ju dha përparësi e veçantë intensifikimit të marrëdhënieve me INTOSAI-n, EUROSAI-n, Gjykatën Europiane të Audituesve, SIGMA-n, etj, si dhe me institucionet homologe të auditimit të jashtëm me eksperiencë, për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës rreth praktikave më të mira të auditimit, sidomos në auditimet e performancës, objektiv kryesor i vendosur për veprimtarinë e ardhshme të KLSH. Marrëveshjet e lidhura me SAI-t e Polonisë, Sllovenisë, Turqisë, Kroacisë dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës shërbyen për shkëmbimin e eksperiencës dhe njëkohësisht edhe për trajnimin e një numri të konsiderueshëm të audituesve tanë, në veçanti për auditimet e performancës.

d. Në një shkallë më të lartë u ngritën marrëdhëniet e KLSH me median e publikun, gjë që reflektohet në paraqitjen transparente të raporteve e rekomandimeve si dhe në ndjekjen e trajtimit korrekt të ankesave e kërkesave të publikut. Tregues i rëndësishëm që flet për transparencën është edhe fakti se analizat periodike të veprimtarisë së institucionit u bënë të hapura në prani të medias së shkruar e asaj vizive.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

5. Planifikimi strategjik

Duke vlerësuar planifikimin strategjik afatgjatë e afatmesëm, për të realizuar auditimet e duhura dhe në kohën e duhur, me objektiv sigurimin e një niveli sa më të lartë të cilësisë së punës audituese, u tregua kujdes në hartimin e zbatimin e programit të veprimtarisë për vitin 2012, ku u ndërthur eksperiencia audituese e arritur në vite me njohuritë e fituara nga trajnimi në kuadër të Projektit të Binjakzimit me NAO-n e Britanisë së Madhe dhe Gjykatën e Llogarisë të Mbretërisë së Hollandës. Kështu, në programin e veprimtarisë së vitit 2012, nga 153 auditime gjithësej të programuara, krahas 128 auditimeve të ligjshmerisë e rregullshmerisë, vlerësues e tematik, u programuan 16 auditime financiare dhe 2 auditime pilot për çertifikim të llogarive sipas praktikave të NAO-s së Britanisë së Madhe dhe 7 auditime të performancës sipas praktikave të Gjykatës së Llogarive të Mbretërisë së Holandës. Në programin e veprimtarisë të vitit 2012, në krahasim me vitin 2011 vërehet një rritje e auditimeve financiare dhe atyre të performancës, kjo si rezultat i objektivave të përcaktuara në platformën e paraqitur nga Kryetari në Kuvend, gjë që tregon se KLSH po drejtohet drejt auditimeve sipas praktikave bashkëkohore.

6. Mësimi nga përvoja

Vëmendje e veçantë në drejtim të funksionimit më të mirë të menaxhimit të cilësisë në nivel institucional, i është kushtuar mësimi nga përvoja (arritjet e dobësitë) e dalë kjo nga konkluzionet e shqyrtimeve të cilësisë dhe rekomandimeve të paraqitura. Konkluzionet, konstatimet dhe rekomandimet e paraqitura në raportin e sigurimit të cilësisë për vitin 2011 u vlerësuan objektivisht nga drejtuesit e KLSH, të cilat u bënë objekt i analizave të departamenteve të auditimit në mënyrë që të reflektohet ndaj të metave të rezultuara dhe të merren masa efektive e të qëndrueshme për përmirësimin e punës në të ardhmen në zbatim të rregullave të brendshme dhe manualeve të miratuara.

7. Mbështetja me IT

Element i rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të cilësisë në nivel institucional, është konsideruar mbështetja dhe shfrytëzimi i përparësive të kompjuterizimit në procesin auditues. Për këtë qëllim, krahas punës për mbajtjen në efikasitet të rrjetit kompjuterik, këtë vit u marrën masa konkrete për rinovimin e pajisjeve kompjuterike me parametrat e teknologjisë bashkëkohore. Duke vlerësuar faktin se auditimi kërkon aftësi speciale, kur subjektet që do të auditohen veprojnë në një mjedis të kompjuterizuar, është kërkuar që audituesit të fitojnë vazhdimisht njohuri të reja mbi sistemet e përdorura nga subjektet e audituara dhe pikërisht për këtë qëllim janë programuar e realizuar trajnime të posaçme për të fituar e zhvilluar këto aftësi, siç janë trajnimet për njohjen me teknologjinë e informacionit (Office 2003 dhe 2007, përdorim i antivirusit, përdorim i emailit të brendshëm) dhe programi IDEA. Po kështu këtë vit u programuan dhe u realizuan edhe trajnimet për programet “Financa 5”, “Alpha” dhe “Oracle”, të cilat nuk u realizuan në vitin 2011 për mungesë burimesh financiare për ekspertët e jashtëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

8. Sigurimi i bazës ligjore

Në vijim të sistemit të menaxhimit të cilësisë në nivel institucional, për arritjen e një niveli sa më të lartë të cilësisë së punës audituese, rëndësi i është kushtuar njohjes dhe përditësimit të vazhdueshëm të audituesve me dispozitat ligjore e nënligjore, si kusht i domosdoshëm për njohjen e vlerësimit të veprimtarisë së subjekteve të audituara, argumentimin e zbulimeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgjegjësisë dhe rekomandimeve përkatëse. Për këtë qëllim, krahas sigurimit të legjislacionit nëpërmjet fletoreve zyrtare, shfrytëzimit të internetit, ndihmës juridike të dhënë dhe përditësimit të vazhdueshëm të paketës me dispozitat ligjore e nënligjore më kryesore nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, me kontrollin e zbatimit të të cilave ndeshen audituesit në veprimtarinë e përditshme, këtë vit në rrjetin kompjuterik u instalua programi elektronik “ALBA-LEX” që ofron baza të dhënash të përditësuara të akteve ligjore e nënligjore.

B. Sistemi dhe procedurat e Kontrollit të Cilësisë (shqyrtime të “nxehta”)

Drejtuesit e institucionit duke e konsideruar objektiv kryesor arritjen e një niveli të lartë të cilësisë së punës audituese, kanë udhëzuar e përqendruar vëmendjen në drejtim të: planifikimit e realizimit të auditimeve të prioritetit më të lartë, duke koordinuar detyrimin ligjor për auditim të subjekteve, me riskun që mbartin në përdorimin e fondeve publike, rëndësisë dhe vlerave të çështjeve të ngritura në auditimet e kryera, objektivitetit dhe drejtësisë në vlerësimet e opinionet e dhëna, besueshmërisë dhe saktësisë së zbulimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve, aktualitetit dhe qartësisë së çështjeve të ngritura në raportet e auditimit, efikasitetin në kryerjen e auditimeve dhe efektivitetin përpara i përket rezultateve dhe ndikimeve që kanë patur në miradministrimin e fondeve publike.

Në zbatim të këtyre objektivave KLSH-ja ka vendosur politika, sisteme dhe procedura që inkurajojnë veprime, të cilat çojnë në një cilësi më të lartë auditimi dhe parandalojnë veprimet që mund të çenojnë cilësinë.

Vendosja dhe përsosja në vazhdimësi e Sistemit të Kontrollit të Cilësisë (shqyrtimet e “nxehta”) ka influencuar ndjeshëm në sigurimin e cilësisë së raporteve të auditimit, duke arritur përmirësime e siguruar praktika më të mira në punën audituese, dhënie e konkluzioneve profesionale e të argumentuara me provat e nevojshme dhe në përfundim me gjykime e vendime objektive. Kontrolli i cilësisë brenda këtij konteksti i referohet kërkesave të zbatuara në menaxhimin e përditshëm të detyrave individuale të caktuara gjatë auditimit, që lidhen me planifikimin, punën në terren, raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Këtij qëllimi i ka shërbyer përcaktimi në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së (miratuar në muajin maj të vitit 2012), të detyrave e përgjegjësisë të hallkave përkatëse, në të cilat kalojnë për shqyrtim, vlerësim e mendim materialet e auditimit, duke filluar nga audituesit, përgjegjësit e grupeve, kryeaudituesit, drejtorët e departamenteve të auditimit, Drejtoria Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtorët e Përgjithshëm, përpara se të merret vendimi përkatës nga Kryetari për miratimin e raportit dhe rekomandimeve përkatëse për subjektin e audituar. E gjithë kjo procedurë është e dokumentuar në të gjitha fazat e auditimit dhe është pjesë përbërëse e dokumenteve të auditimit në dosjen përkatëse.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

C. Procesi i Sigurimit të Cilësisë (shqyrtime të “ftohta”)

Kjo procedurë e kryer nga struktura e veçantë brenda institucionit e ngritur për këtë qëllim, pas evadimit e arkivimit të dosjeve të auditimeve, që realizohet në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI, ISSAI 1220, rekomandimeve të SIGMAS, urdhërave të brendshme, Rregullores së Brendshme të Organizimit e Funkcionimit të KLSH-së, ka shqyrtuar realizimin e sigurimit të cilësisë të një numri të caktuar të auditimeve, për të verifikuar në se ato politika, strategji e rregulla të përcaktuara në rregulloren e brendshme e manualët e auditimit janë zbatuar me rigorozitet në të gjitha fazat që kanë të bëjnë me programimin, zbatimin dhe raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të punës audituese.

Ky është një proces që kryhet brenda institucionit për t'u siguruar që: janë kryer auditimet e nevojshme, ato janë zhvilluar siç duhet, janë përcaktuar rrugët e mundshme të fuqizimit të auditimit, si dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e punës në të ardhmen. Për këtë qëllim KLSH ka adoptuar politika dhe procedura, për të rishikuar efikasitetin dhe efektivitetin e standardeve dhe procedurave të brendshme të kontrollit të cilësisë.

Puna për shqyrtimin e auditimeve për sigurimin e cilësisë, është bërë sipas urdhërit të brendshëm të Kryetarit të KLSH-së, bazuar në kërkesat e formularit tip të miratuar për këtë qëllim, duke u përqendruar në drejtim të :

- Përzgjedhjes dhe planifikimit me përparësi të subjektit të auditimit.
- Hartimit të programeve të auditimit në zbatim të rregullores së brendshme dhe standardeve të kontrollit të KLSH-së.
- Përzgjedhjes së grupit të auditimit me numrin dhe aftësitë e kërkuara për realizimin e programit të auditimit.
- Përcaktimit dhe respektimit të afateve të përfundimit të auditimeve.
- Zbatimit të procedurave e teknikave për sigurimin e provave.
- Zbatimit të rregullores e standardeve të kontrollit për hartimin e dorëzimit e dokumenteve të auditimit dhe formën e paraqitjes së raportit të auditimit.
- Mbështetjes së zbulimeve e konkluzioneve me prova të sakta.
- Vlerësimit e pasqyrimin në raport të observacioneve të subjektit dhe organizimit të ballafaqimeve.
- Formulimit të saktë dhe të argumentuar të rekomandimeve.
- Zbatimit të rregullave të etikës në marrëdhëniet me subjektin e audituar.
- Evadimit të rezultateve të auditimit sipas përmbajtjes, afateve dhe drejtimeve të duhura.

Veç kërkesave të mësipërme të përcaktuara në formularin e miratuar nga KLSH, gjatë shqyrtimit të disa auditimeve për sigurimin e cilësisë, iu referuam edhe kërkesave të përcaktuara në manualët e formularët e hartuar në bashkëpunim me specialistet e projektit të binjakëzimit.

Për auditimet financiare të cilat gjejnë pasqyrim në Manualin e Auditimit Financiar të vitit 2009, shqyrtimi i tyre për sigurimin e cilësisë u bë duke koordinuar kërkesat e formularit të miratuar me urdhërin e brendshëm të ish-Kryetarit të KLSH-së nr. 6 datë 15.01.2007 dhe ato të listës verifikuese për rishikimin e cilësisë (shtojca A) të hartuar në bashkëpunim me specialistët e projektit dhe të miratuar me shkresën nr. 702 datë 21.11.2008. Lista verifikuese përmban disa elementë të rinj për rishikimin e cilësisë, të parashikuar këto edhe në Manualin e Auditimit Financiar për të gjitha fazat e auditimit (programim, zbatim dhe raportim të punës audituese) që kanë të bëjnë kryesisht me:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

- Vlerësimin e riskut dhe përcaktimin e materialitetit.
- Identifikimin e sistemeve e kontrolleve kyçe.
- Testimin e kontrolleve kyçe.
- Dokumentimin e punës dhe rishikimin e letrave të punës.
- Dokumentimi i kontakteve kyçe me subjektin.
- Vlerësimin e auditit të brendshëm, marrjen në konsideratë të rezultateve të tij.
- Rishikimin e sistemeve të kontabilitetit.
- Adresimin e çështjeve të dala nga auditimi i mëparshëm.
- Kontrollin e pasqyrave financiare.
- Krahasimin e gabimeve me nivelin e materialitetit të llogaritur.
- Dokumentimin e gjithë takimeve të grupit me subjektin gjatë gjithë auditimit, etj.

III. ZBULIMET DHE KONKLuzionET E SHQYRTIMIT (“TË FTOHTË”) PËR VITIN 2012

Shqyrtimi për sigurimin e cilësisë për vitin 2012, u krye në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr.112, datë 21.12.2012, ku u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme 20 dosje auditimi rreth - 13 % e auditimeve të kryera gjatë këtij viti (të evaduara dhe të arkivuara) nga të gjithë departamentet e auditimit.

Në vijim të praktikës së vitit të kaluar, edhe këtë vit sipas urdhërit të Kryetarit u angazhuan grup audituesish nga çdo departament, nën mbikëqyrjen e specialistëve përkatës të Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, ku secili nga specialistët e grupit shqyrtoi dosje që nuk i përkitnin departamentit të tyre, në mënyrë që të jepej një opinion sa më i pavarur dhe objektiv. E veçantë për këtë vit është së përzgjedhja e dosjeve për shqyrtim u bë nga vetë grupet e ngarkuara.

Për vlerësimin e sigurimit të cilësisë të vitit 2012, sipas programit vjetor të auditimit, krahas auditimeve të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësues, për procesin e shqyrtimit të sigurimit të cilësisë u përzgjedhën edhe auditime financiare të kryera sipas praktikave të NAO-s dhe auditime të performancës të kryera sipas praktikave të Gjykatës së Llogarive të Mbretërisë së Holandës. Kjo tregon se KLSH po orientohet drejt zbatimit të metodave bashkëkohore të auditimit, për të cilat kërkohen ritme më të shpejta në vitet në vazhdim, me synimin aplikimin e metodave të reja në auditim, duke i dhënë prioritet auditimeve të performancës, krahas forcimit të atyre financiare.

Duhet theksuar se në nivel institucional, raporti për sigurimin e cilësisë për vitin 2011 u vlersua në shkallën e duhur nga drejtuesit e KLSH-së, mbasi për këtë qëllim u urdhërua dhe u realizuan analizat në çdo departament, si dhe konkluzionet e raportit të sigurimit të cilësisë u pasqyruan në raportin vjetor të veprimtarisë së KLSH.

Një ndër faktorët pozitiv që ka ndikuar në sigurimin e cilësisë së punës audituese është edhe përgatitja më e studiuar e programit vjetor të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2012, që lidhet me punën e bërë në përcaktimin e prioriteteve të mundshme, argumentimin dhe përfshirjen në program të subjekteve të auditimit mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të materialitetit, duke i kombinuar këto auditime edhe me detyrimet kushtetuese e ligjore që ka KLSH-ja për auditimin periodik të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

Hartimi e zbatimi i programeve të auditimit konform Rregullores së Brendshme të KLSH-së e manualeve të auditimit, përzgjedhja e përcaktimi i grupeve të auditimit me numrin e aftësitë e kërkuara që sigurojnë zbatimin e programit, nxjerrja e konkluzioneve të drejta dhe formulimi i drejtë i rekomandimeve, masat me karakter organizativ për përmirësimin e gjendjes të marra gjatë periudhës së auditimit, propozimet për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore, masat e marra nga subjektet për programimin e detyrave për zbatimin e rekomandimeve, flasin për një arritje të kënaqshme të sigurimit të cilësisë, si dhe të rritjes së besueshmërisë e objektivitetit të konkluzioneve dhe vendimeve të strukturave drejtuese e zbatuese të KLSH-së.

Referuar konstatimeve të dala nga shqyrtimi i dosjeve të auditimit, të cilat paraprakisht janë diskutuar me përgjegjësit e grupeve dhe drejtorët e departamenteve përkatëse, rezulton se krahas punës së bërë dhe rezultateve të arritura në drejtim të sigurimit të cilësisë, në procesin e programimit, zbatimit, raportimit të përfundimeve të auditimeve dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, u konstatuan edhe disa të meta e mangësi në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, e Manualit e Auditimit, ndaj të cilave kërkohet të reflektohet me masa konkrete tekniko-administrative të qëndrueshme, pasi influencojnë në arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë në të gjithë veprimtarinë e KLSH-së.

Në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e shqyrtimit janë si më poshtë:

A. Faza e planifikimit të auditimit:

1. Për mbarëvajtjen e punës audituese, hartimin e një programi auditimi sa më të plotë dhe përdorimin sa më racional të burimeve njerëzore e materiale, në Rregulloren e Brendshme është parashikuar njoftimi i subjektit para fillimit të kontrollit, që ka për qëllim vënien në dispozicion të dokumentacionit për marrjen e informacionit paraprak, sigurimin e ambienteve e pajisjeve për një punë normale të audituesve, si dhe kërkesa të tjera në vartësi të specifikave dhe natyrës së auditimit apo subjektit.

Nuk është bërë mbledhja e informacionit paraprak nga grupi i auditimit për subjektin e audituar dhe nuk është bërë analiza e fakteve ose e të dhënave të mjaftueshme me qëllim arritjen e konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme rreth subjektit për hartimin e programit të auditimit, si rrjedhojë programet e auditimit janë të ngjashme pa u thelluar në veprimtarinë dhe specifikat e subjektit, gjë që ka sjellë shpesh përfshirjen e pikave pa rrisht në programin e auditimit. Kërkesë kjo e parashikuara në nenin nr. 19.2, pika 3.3 e Rregullores së Brendshme e vitit 2005 dhe neni 10.4.2 “Mbledhja e të dhënave paraprake e Rregullores së Brendshme viti 2012, Dokumenti nr.1.

Në 15 nga 20 dosje të shqyrtuara rezulton se kjo kërkesë nuk është zbatuar. (Auditimi i Bankës së Shqipërisë; Ministria e Turizmit, Rinisë dhe Sporteve; Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor; Autoriteti Rrugor Shqiptar. Projekti: “Rruga Milot-Rrëshen”; TEC Vlora sha; Porti Detar Shëngjin-Lezhë sha; Autoriteti i Aviacionit Civil; Agjencia Rajonale e Mjedisit të Qarkut Korçë; Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Lushnje; Bashkia Orikum; Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Durrës; Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Dega e Doganës, Qafë Botë).

2. Duke patur parasysh kërkesat për auditim, duhet të ishte treguar një kujdes më i madh në përzgjedhjen e auditimeve të prioritetit sa më të lartë, ku të merrej parasysh risku dhe materialiteti. Kërkesë kjo e parashikuar në nenin nr. 19.2, pika 1.2 e Rregullores së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

Brendshme të vitit 2005, Standardet e Kontrollit, kapitulli II, pika 2.1.3, kapitulli III, pika 3.1 dhe Argumentimi në Planin Vjetor, si dhe neni 10.3, pika 1, 2, 3 e Rregullores së Brendshme të vitit 2012. Kjo mangësi u konstatuar në auditimin e “Drejtorisë Rajonale Arsimore – Shkodër” i cili ishte një objekt jashtë planit të auditimit.

3. Menaxhimi racional kërkon që planifikimi i burimeve njerëzore të vlerësohet në mënyrë të atillë që në auditim krahas numrit të përshtatshëm të audituesve të caktohet edhe stafi me aftësitë dhe eksperiencën e duhur, në mënyrë që cilësia e aftësive të grupit t’i përgjigjet kompleksitetit të auditimit. Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se planifikimi i burimeve nuk është bërë sipas faktorëve të përcaktuar, pasi jo të gjithë anëtarët e grupit të auditimit janë me eksperiencë në fushën që auditohet, si dhe ka raste të shtimit apo pakësimit të anëtarëve të grupit pas hartimit të programit të auditimit, ndryshime këto të pa argumentuara dhe të dokumentuara, kërkesë kjo e parashikuar në Rregulloren e Brendshme dhe Dokumentet Standarde. Në 5 auditime nga 20 të shqyrtuara, këto kërkesa nuk janë vlerësuar me kujdesin e duhur. Kjo mangësi u konstatua në auditimet:

- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Lushnje.
- Bashkia Orikum.
- Komuna Zharrëz.
- Agjensia e Kthimit Kompensimit të Pronave-Tiranë.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier.

4. Hartimi i programeve të auditimit pa bërë më parë njohjen e subjektit, ka sjellë si pasojë hartimin e programeve jo të plota, janë përcaktuar si pika auditimi megjithëse subjekti nuk ka ushtruar aktivitet në lidhje me to; nuk është dhënë e plotë baza ligjore; ka ndryshime të afateve të auditimit, që tregojnë mos thellim para hartimit të këtyre programeve, kërkesa këto të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, pika 10.4.3 e 10.4.4 si dhe Dokumenti nr.4.

Kjo mangësi u konstatua në 5 (pesë) auditime:

- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Lushnje.
- Bashkia Orikum.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Durrës.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

5. Nuk është përfshirë në programin e auditimit “Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit”, drejtim kyç për vlerësimin e riskut dhe menaxhimit, kërkesë kjo e parashikuar në ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk bëhet vlerësimi i punës së auditimit të brendshëm dhe në ç’farë shkalle mund të përdoren rezultatet e tij në punën e grupit të auditimit, gjë që parashikohet si në Standardet Ndërkombëtare ashtu dhe në Standardet e Auditimit të KLSH, ashtu si dhe në ndonjë rast, nuk është përfshirë në programin e auditimit veprimtaria ekonomiko-financiare e subjektit, duke e përfruar me një auditim tematik. Këto kërkesa janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, pika 10.4.3, Standardet e KLSH 3.3.2 dhe në dokumentin 4- Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë.

Kjo mangësi u konstatua në 4 (katër) auditime:

- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Lushnje.
- Bashkia Orikum.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Durrës.
- Agjensia e Kthimit Kompensimit të Pronave-Tiranë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

6. Ndarja e detyrave nuk është miratuar nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, që do të ndikonte në vlerësimin e punës për çdo auditues, kërkesë e Rregullores së brendshme, neni 10.4.1, neni 12 dhe dokumenti nr.5. Kjo mangësi u konstatua në 1 (një) auditim: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

7. Ka raste të ndryshimeve të programit të auditimit, pa kërkesë dhe argumentim, që ka ardhur si pasojë e mosnjohjes së mirë të subjektit që auditohet dhe mosnjohjen me problematikat e auditimeve të mëparshme. Është kërkuar shtyrje afati i pabazuar në nevojën e auditimit të thelluar, duke e bërë jo efektiv siç kërkohet në Rregulloren e Brendshme neni 10.4.4, pika 3.

Kjo mangësi u konstatua në 3 (tre) auditime:

- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Lushnje.
- Bashkia Orikum.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Durrës.

B. Faza e kryerjes së Auditimit

8. Mos zbatim i përcaktimeve në rregullore të hartimit të aktverifikimeve dhe procesverbaleve, si dhe mos përcaktim të neneve dhe pikave përkatëse të shkeljeve, por është mjaftuar vetëm me vendosjen e dispozitës ligjore. Zgjatje me përshkrime, kur në fakt nuk konstatohet asnjë shkelje dhe mangësi apo referenca të gabuara ligjore për shkeljet e konstatuara, apo në ndonjë rast, përcaktohen shkelje dhe nuk ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës, kërkesë kjo e parashikuara në nenin nr. 20.2, pika “b” e Rregullores së Brendshme të vitit 2005 dhe Dokumentet 6,7,8 të Rregullores së Brendshme të vitit 2012, dokumenti 6-Dokumente dhe formularë standard të auditimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare. Kjo mangësi u konstatuan në 4 (katër) auditime:

- Auditimi i Bankës së Shqipërisë.
- Komuna Zharrez.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

9. Konstatohet një praktikë pune që ka të bëjë me dorëzimin e të gjithë procesverbaleve e aktverifikimeve në zyrat e protokollit të subjekteve. Mënyra e mbajtjes dhe e dorëzimit të aktverifikimeve dhe për më tepër e procesverbaleve në rrugë protokollare dhe jo ti dorëzohen personave me të cilët mbahet, si dhe atyre të larguar, që në disa raste nuk dokumentohet që këta persona të larguar janë njohur me shkeljet e konstatuara.

Si rezultat i kësaj praktike, në dosjet e auditimit në përgjithësi këto dokumente arkivohen vetëm me shënimet e numrave të protokollit dhe firmat e kontrollorëve, por pa firmat e personave të atakuar, ku jo të gjithë bëjnë observacione dhe pa një konfirmim nga zyrat e protokollit për dorëzimin e këtyre dokumenteve ose vënien në dijeni të personave përkatës, për të shmangur ndonjë pretendim për mos marrje dijeni për përmbajtjen e këtyre dokumenteve dhe shmangie ndaj përgjegjësisë të personave të atakuar. Madje në një rast ato shprehen: “... nuk janë prezantuar problemet përpara, me to jemi njohur nga procesverbali i mbajtur...”, veprime këto jo në përputhje me Rregulloren e Brendshme, (Dokumentet standarde, nr.6, 7,8) dhe neni 20.1 a.

Kjo mangësi u konstatua në 2 (dy) auditime:

- Auditimi i Agjensisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Korçë.
- Agjencia e Kthimit Kompensimit të Pronave-Tiranë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

10. Megjithëse shkeljet e konstatuara janë shkelje ligjore, nuk janë mbajtur procesverbal dhe nuk janë ngarkuar me përgjegjësi, personat përkatës përgjegjës, por është mbajtur aktverifikim. Kërkesë kjo e parashikuar në Rregulloren e Brendshme dhe Dokumentet Standarde, mangësi kjo e konstatuar në 2 (dy) auditime:

- Auditimi i Agjensisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Korçë.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier.

11. Trajtimi i shkeljeve direkt në Projektraportin e Auditimit pa hartuar më parë procesverbale apo aktverifikime, sjellë mospërcaktim të përgjegjësive dhe nuk i jep mundësi personave përgjegjës për të bërë vërejtje para hartimit të Projektraportit të Auditimit, kërkesë kjo e parashikuar në pikën 11.3.3 të Rregullores së Brendshme. Kjo mangësi u konstatua në 1 (një) auditim:

- Auditimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar. Projekti “Ruga Milot-Rrëshen”.

C. Faza e Raportimit dhe Evadimit të materialeve të auditimit.

12. Megjithëse vihen re përmirësime në trajtimet e observacioneve, në ndonjë rast në dosjet e shqyrtuara, në Raportet Përfundimtare të Auditimit nuk jepen sqarimet e plota për observacionet e bëra për Projektraportin, ku duhet të përshkruhet shkurt thelbi dhe përmbajtja e observacionit dhe argumentimi me dispozita ligjore kur nuk merret në konsideratë, e që për observacionet e pabazuara të mos përdoret thjesht shprehja “nuk qëndron observacioni...”. gjë që do të përforconte konkluzionin e audituesve për shkeljet e konstatuara dhe do të rriste sigurinë e besueshmërinë e konkluzioneve e rekomandimeve të auditimit. Kjo kërkesë është e parashikuar në nenin nr. 6 të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, pika 10.5.6 dhe pika 10.6.6.2 e Rregullores së Brendshme, mangësi kjo e konstatuar në 3 (tre) auditime:

- Auditimi i Performancës së “Agjensisë Telegrafike Shqiptare”.
- Agjencia e Kthimit Kompensimit të Pronave-Tiranë.
- Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Korçë.

13. Vërehen të meta e mangësi në trajtimin më të plotë të pikave të programit të auditimit ku mungojnë gjetjet dhe konkluzionet. Projektraportet e Auditimit dhe për më tepër Raportet Përfundimtare nuk janë në përputhje me Rregulloren e Brendshme. Raportet janë shumë të gjata dhe janë pasqyrim (kopje) thjesht i procesverbaleve dhe aktverifikimeve të mbajtura. Përshkrimi i zbulimeve në raportin e auditimit duhet të ishte një përmbledhje e problemeve të dala gjatë auditimit, kërkesë kjo e përcaktuar në Rregulloren e Brendshme pika 10.6.6.4, mangësi që u konstatua në 4 (katër) auditime:

- Komuna Zharrëz
- Agjencia e Kthimit Kompensimit të Pronave-Tiranë.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier.
- Dega e Doganës Sarandë, Qafë Botë.

14. Nuk realizohen takimet përmblylëse me subjektin para hartimit të Projektraportit për të ballafaquar e ndjekur deri në fund çështjet e dala gjatë auditimit. Ose në disa raste ballafaqimet nuk janë dokumentuar mirë, jo thjesht të flitet për organizimin e takimit, por të përshkruhen problemet e dala dhe vërejtjet e personave përgjegjës pjesëmarrës në këto ballafaqime, kërkesë kjo e parashikuar në pikën 10.5.5 të Rregullores së Brendshme.

Kjo mangësi u konstatua në 6 (gjashtë) auditime:

- Auditimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar. Projekti: “Ruga Milot-Rrëshen”.
- Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Korçë.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Durrës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

- Komuna Zharrëz
- Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave-Tiranë.
- Dega e Doganës Sarandë, Qafë Botë.

15. Nuk është hartuar informacion për Projektraportin e Auditimit për informimin e drejtorit të departamentit, me qëllim dhënien e kontributit të tij me shkrim në këtë auditim, kërkesë e Dokumentit 9 të Rregullores së Brendshme, Dokumente Standarde, mangësi e konstatuar në 1 (një) auditim:

Mangësi të kësaj natyre u konstatua në 1 (një) auditim:

- Dega e Doganës Sarandë, Qafë Botë.

16. Mungon dokumenti “16”, në mënyrë që të evidentohen rezultatet e auditimit dhe përgjegjësia individuale. Bashkëlidhur Raportit Përfundimtar, duhet të shënohen për çdo auditues pikat e trajtuara, masat e rekomanduara dhe faqet respektive të raportit për Auditimet e Ligjshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare, kërkesë kjo e parashikuar në Rregulloren e Brendshme që u konstatua në 1 (një) auditim:

- Auditimi i Portit Detar Shëngjin.

17. Kërkesat e përcaktuara në nenin 16, paragrafi 3 të ligjit organik të KLSH-s dhe Rregullores së Brendshme, nuk janë vlerësuar në shkallën e duhur nga grupet e auditimit dhe drejtuesit e departamentit për rastet e konstatimit të shkeljeve dhe përcaktimit të masës së zhdëmtimit dhe të përgjegjësisë të personave përkatës. Në projektvendim, megjithëse shkeljet e konstatuara janë shkelje të rënda ligjore, nuk është propozuar masë disiplinore për të gjithë personat e ngarkuar me përgjegjësi, janë rekomanduar masa organizative të cilat janë detyra funksionale të subjektit, pasaktësi në argumentimin e rekomandimeve dhe në ndonjë rast projektvendimi nuk është i firmosur në çdo faqe të tij, mangësi këto të konstatuara në 4 (katër) auditime:

- Auditimi i Agjensisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Korçë.
- Agjensia e Kthimit Kompensimit të Pronave-Tiranë.
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier.
- Dega e Doganës Sarandë, Qafë Botë.

Kështu, në auditimin në “Agjencinë Rajonale të Mjedisit të Qarkut Korçë” u konstatua se:

Nuk janë rekomanduar masa për të gjithë personat të ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Tipik është rasti që nuk është propozuar masë disiplinore ndaj z. Artur Dvorani, me detyrë ish-Kryetar i ARM, Qarku Korçë, periudha 29.12.2009 deri më 10.01.2012 aktualisht inspektor, i liruar nga detyra e kryetarit me urdhër të Ministrit nr.5, datë 10.01.2012 (në këtë urdhër nuk pasqyrohen arsyet e liritimit) edhe pse janë konstatuar një sërë shkeljesh, për të cilat duhej të propozohej masë disiplinore për largim nga puna (Zgjidhje e kontratës së punës) bazuar në ligjin nr. 10279, datë 20.05.20110 “Për kundravajtjet administrative”, neni 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ” ku përcaktohet se: “...Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundravajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna...”.

18. Shumë nga mangësitë e konstatuara në dosjet e kontrolluara janë pjesë e kontrollit të cilësisë dhe në veçanti e kontrollit që duhet të ushtrohet brenda departamentit të auditimit në të gjitha fazat e tij, gjë që tregohet nga mungesa në disa raste e mendimit të kryeaudituesit, kërkesë kjo e parashikuar në Rregulloren e Brendshme, mangësi të konstatuara në 3 (tre)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

auditime:

- Komuna Zharrëz
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme-Fier.
- Dega e Doganës Sarandë, Qafë Botë.

19. Nuk është plotësuar dokumenti 17 “Vlerësimi i cilësisë së kontrollit”, përcaktuar në nenin 10.6.8, Aneksi 2- Dokumente dhe Formularë standard të auditimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, mangësi të konstatuara në 3 (tre) auditime:

- Agjencia e Kthimit Kompensimit të Pronave-Tiranë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Dega e Doganës Sarandë, Qafë Botë.

20. Evidencat e rezultateve të auditimit (Formularët standard) janë plotësuar pjesërisht me mungesa. (Formularët 1/1 deri 12/1 sipas Rregullores së re të vitit 2012, mangësi që u konstatuan në 1 (një) auditim:

- Auditimi i Drejtorisë Rajonale Arsimore –Shkodër (objekt jashtë plani)

21. Mungojnë letrat e punës dhe shënimet e mbajtura nga audituesi. Kërkesë e Dokumenteve standarde, neni 10.7, pika 2,3 dhe 6 Formularë standardë, mangësi që u konstatua në 1 (një) auditim:

- Dega e Doganës Sarandë, Qafë Botë.

Gjithashtu, pjesë e këtij raporti janë edhe konstatimet nga shqyrtimi për sigurimin e cilësisë të disa dosjeve të auditimit gjatë vitit sipas urdhërave të Kryetarit, rezultatet e të cilave janë ezauruar brenda vitit.

I. Mbi sigurimin e cilësisë në praktikën e Auditimit në “Drejtorinë Rajonale të Aluizmit, Qarku Vlorë”.

Në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të KLSH nr.112, datë 21.12.2012, “Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë” është bërë shqyrtimi në lidhje me auditimin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Aluizmit, Qarku Vlorë..Grupi i shqyrtimit pasi analizoi Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore, konstatoi se:

-Masat administrative dhe disiplinore të propozuara nga grupi i auditimit për personat përgjegjës, nuk janë në raport me shkeljet e konstatuara dhe të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

-Gjithashtu mendojmë se ka elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 248 “shpërdorimi i detyrës”, i Kodit Penal, kryer nga personi që ka ushtruar funksione publike në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë edhe për z. **Gentian Zeneli**, me detyrë specialist në Sektorin e Hartografisë dhe GIS në Drejtorinë e Sarandë, me cilësinë e ish-Përgjegjës Sektori GIS në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Vlorë.

Për sa më lart u rekomandua që:

Nga grupi i auditimit duhet të rivlerësohet edhe një herë Raporti Përfundimtar i Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Drejtoria Rajonale Vlorë, për pjesën e trajtuar në faqet nr. 24-78, si dhe të bëhet një shtesë e rekomandimeve të propozuara ku të forcohen masat disipline në raport me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

shkeljet e konstatuara për **z. Gentian Zeneli**, me detyrë specialist në Sektorin e Hartografisë dhe GIS në Drejtorinë e Sarandë, me cilësinë e ish-Përgjegjës Sektori GIS në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Vlorë si dhe të shikohen elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 248 “*shpërdorimi i detyrës*”, i Kodit Penal, kryer nga ky person.

II. Mbi sigurimin e cilësisë në praktikën e Auditimit në “Bashkinë Lezhë”.

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit nr.96, datë 02.11.2012, bazuar dhe në pikën 2 të këtij urdhëri, është bërë shqyrtimi për kontrollin e sigurimit të cilësisë për dosjen nr.4 të vitit 2012 në lidhje me kontrollin e ushtruar në Bashkinë Lezhë, nga ku rezultoi se:

Për disa zbulime të konstatuara nga grupi i kontrollit, për të cilat ka patur observacione nga punonjës të subjektit të kontrolluar, kontrollorët në zbatim të nenit 6 të ligjit organik, rregullores së brendshme dhe pikave 3.10.2 dhe 4.2.2 të standardeve të kontrollit të KLSH-së, nuk i kishin shqyrtuar e ballafaquar ato me subjektin dhe nuk i kishin pasqyruar në raportin përfundimtar për t’i evidentuar nëse ato ishin të drejta ose jo dhe të reflektoheshin para se ti paraqiteshin për miratim drejtuesve të KLSH-së. Fakti që ka munguar ballafaqimi për shkeljet e trajtuara në materialet e kontrollit, për një pjesë të të cilave ka patur edhe observacione, tregon se edhe formulimi e argumentimi i rekomandimeve ka qenë jo i plotë.

Mbajtja e procesverbaleve e aktverifikimeve ishte konform rregullores së brendshme, standardeve të kontrollit dhe formularëve standard, por nga verifikimi rezulton se dorëzimi i disa prej tyre dokumenteve në rrugë protokollare është në kundërshtim me nenin 20.2.a./8,9,10 të Rregullores së Brendshme, pasi një praktikë e tillë aplikohet për personat që nuk pranojnë të marrin në dorëzim e të firmosin dhe ato që janë të larguar, që megjithëse janë njoftuar për t’u paraqitur e dhënë sqarime, nuk paraqiten. Shkelje të kësaj natyre në kundërshtim me rregulloren e brendshme u konstatuan në hartimin e këtyre dokumentave, ku rezulton se disa prej tyre janë dorëzuar në zyrën e protokollit të subjektit, në ditën e fundit të përfundimit të kontrollit në subjekt, të pa firmosur edhe nga personat e atakuar që janë në marrëdhënie pune, gjë që tregon se për shkeljet e trajtuara nuk është bërë paraprakisht ballafaqim sipas rregullores, veprim i cili do të eliminonte observacionet e panevojshme.

Ndonëse afati i qëndrimit në subjekt ishte respektuar, i njëjti kujdes duhet të ishte treguar në të gjitha fazat e evadimit për respektimin e afateve të përcaktuara në nenin 19.1 të Rregullores së Brendshme dhe pikës 3.5 të Standardeve të Kontrollit, pasi kontrolli quhet i përfunduar vetëm atëherë kur është miratuar nga Kryetari. Ky kontroll kishte përfunduar rreth 3 muaj tej afateve të përcaktuara, që për këtë tejkallim në doje duhet të kishte sqarimet përkatëse të dokumentuara, pavarësisht se për këtë tejkallim kishte edhe arsye objektive të cilat duhet të pasqyroheshin, siç ishte mungesa e vendimmarrjes për efekt të mbarimit të mandatit të ish drejtuesit të KLSH.

Ndryshimet e konstatimeve e konkluzioneve nga procesverbali, projektraporti, raporti përfundimtar, projektvendimi dhe vendimi, nuk janë shoqëruar me sqarimet përkatëse, duke shpjeguar arsyen e këtyre ndryshimeve. Në rast se këto ndryshime janë rezultat i zbulimit të fakteve të reja, reflektimit ndaj observacioneve të paraqitura nga subjekti, apo rezultat i ndonjë ballafaqimi të organizuar me subjektin, këto fakte duhet të trajtoheshin në raportin përfundimtar, duke reflektuar në projektvendim e vendim, kërkesë kjo e nenit 20.2.d.1,4 të rregullores së brendshme dhe pikës 4.2.2 të standardeve të kontrollit, jo vetëm për të lënë gjurmët e ndryshimit, por edhe për t’i treguar subjektit se observacionet e tyre janë vlerësuar, shqyrtuar, marrë në konsideratë e reflektuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

III. Mbi Sigurimin e Cilësisë në praktikat e auditimit të ushtruar në:

1. Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tatim Paguesit e Mëdhenj, Tiranë

2. Njësinë e Mbikëqyrjes së Lodrave të Fatit, Tiranë

3. Drejtorinë Rajonale Tatimore, Elbasan.

Shqyrtimi për sigurimin e cilësisë së kontrollit të ushtruar në subjektet e mësipërme, u krye në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit nr.105, datë 26.11.2012, sipas drejtimeve të përcaktuara në atë urdhër, që në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e shqyrtimit janë si vijon:

1. Në dosjen e auditimit të kontrollit në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tatim Paguesit e Mëdhenj Tiranë, veç të tjerave u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore të mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që kanë të bëjnë me:

- a) Trajtim i ndryshëm i të njëjtit fenomen nga një subjekt tatimpagues tek tjetri
- b) Mospasqyrimi në raport i detyrimeve të konstatuara në procesverbale

Si rezultat i veprimeve të mësipërme, për të gjitha rastet e pa evidentuara të kontributeve, dëmi ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 13,231,358lek, për të cilën u bë kallëzim në organin e prokurorisë për kontrollorin përkatës për shpërdorim detyre

2. Në dosjet e kontrollit në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan dhe në Njësinë e Mbikëqyrjes së lojërave të Fatit, nuk u vunë re probleme, përveçse çështjeve të trajtuara më poshtë.

3. Në mënyrë që zbulimet, konkluzionet dhe rekomandimet e kontrollit të përshkruhen objektivisht, me vërtetësi, të preçizuar dhe të argumentuara me dispozitat ligjore, është e domosdoshme mbajtja e procesverbaleve e aktverifikimeve konform rregullores së brendshme, standardeve të kontrollit dhe formularëve standard. Nga verifikimi rezulton se forma e këtyre dokumenteve është në përputhje me rregullat e brendshme, por dorëzimi i gjithë këtyre dokumenteve në rrugë protokollare, është në kundërshtim me nenin 20.2.a./8,9,10 të Rregullores së Brendshme, pasi një praktikë e tillë aplikohet për personat që nuk pranojnë të marrin në dorëzim e të firmosin dhe ato që janë të larguar, që megjithëse janë njoftuar për t'u paraqitur e dhënë sqarime, nuk paraqiten. Shkelje të kësaj natyre në kundërshtim me rregulloren e brendshme u konstatuan në tre subjektet e shqyrtuara. Kështu:

- Në subjektin **Drejtoria Rajonale Tatimore, Tatim Paguesit e Mëdhenj** janë dorëzuar në rrugë protokollare 104 procesverbale, të pa firmosur nga personat me të cilët janë mbajtur ato, të mbajtur pothuajse të gjithë në fund të afatit të qëndrimit në subjekt dhe në 5 raste jashtë këtij afati dhe të dorëzuar në protokoll të gjithë brenda një dite, pra mbas afatit të përfundimit të kontrollit në subjekt, në kundërshtim me rregulloren. Fakti që në 71 procesverbale janë 135 punonjës në detyrë që nuk kanë firmosur dhe nuk kanë observuar, tregon se këto punonjës nuk janë njohur paraprakisht me këto dokumente siç e kërkon rregullorja dhe nuk ka dokumente nga zyra e protokollit që vërteton se punonjësit janë njoftuar e vënë në dijeni me përmbajtjen e procesverbaleve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për 55 ish punonjës të larguar nga detyra, për të cilët nuk ka konfirmim nëse janë njoftuar.

- Në subjektin **Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit** janë dorëzuar në rrugë protokollare 37 procesverbale të pa firmosur nga personat me të cilët janë mbajtur, të dorëzuar pothuajse në fund të përfundimit të kontrollit në subjekt dhe në 4 raste mbas këtij afati, në kundërshtim me rregulloren. Fakti që në 18 procesverbale janë 30 punonjës në detyrë që nuk kanë firmosur dhe nuk kanë observuar, tregon se këto punonjës nuk janë njohur paraprakisht me këto dokumente dhe nuk ka dokumente nga zyra e protokollit që vërteton se



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

punonjësit janë njoftuar e vënë në dijeni me përmbajtjen e procesverbaleve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për 6 punonjës të larguar nga detyra, për të cilët nuk ka konfirmim se janë njoftuar.

- Në subjektin **Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan**, rezulton se nga 23 procesverbale gjithsej, 22 prej tyre janë mbajtur rreth 4 dit mbas përfundimit të kontrollit në subjekt dhe dorëzuar të gjithë brenda një dite në zyrën e protokollit të subjektit, 5 dit mbas përfundimit të kontrollit, pra e njëjta formë veprimi si në dy subjektet e mësipërme.

Veç këtyre mangësive, hartimi i këtyre dokumenteve pothuajse në ditën e fundit të kontrollit në subjekt dhe dorëzimi jashtë këtij afati siç theksuam më lart, ka ndikuar kryesisht në tejkalimin e afateve të përgatitjes e nisjes së projektraportit, të përgatitjes së raportit përfundimtar etj.

4. Respektimi i afatit të kryerjes së kontrollit sipas programit të miratuar dhe çdo ndryshim i tij me miratim të Kryetarit, është detyrim ligjor institucional për t'u zbatuar, i përcaktuar ky në nenin 19.1 të Rregullores së Brendshme dhe pikës 3.5 të Standardeve të Kontrollit dhe çdo ndryshim në afatin e kryerjes së çdo faze të kontrollit duhet të shoqërohet me kërkesë me shkrim dhe miratim nga Kryetari.

Referuar afateve të përcaktuara në rregullore, kontrolli në **Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tatim paguesit e Mëdhenj është evaduar me 49 ditë kalendarike tej afateve të përcaktuara**, në subjektin **Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit 37 ditë kalendarike** dhe në subjektin **Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan 34 ditë kalendarike tej afateve të përcaktuara**, që për këtë tejkalim në dosje nuk ka sqarim apo argumentim nga drejtuesit e departamentit në formë të dokumentuar dhe miratim nga Kryetari.

Për këto tejkalime afatesh në dosjet e shqyrtuara nuk ka sqarime apo argumentime nga drejtuesit e departamentit në formë të dokumentuar dhe miratim nga Kryetari

Nga verifikimi në arkiv, del se në këto subjekte nuk rezulton të jetë bërë kontroll në fund të vitit për zbatimin e rekomandimeve, veprim ky në kundërshtim me rregulloren dhe standardet e kontrollit.

Në krahasim me vitin e kaluar rezulton se kemi një rritje të numrit të auditimeve të shqyrtuara. E themi këtë pasi, në se vitin 2011 u shqyrtuan 16 auditime, këtë vit u shqyrtuan 25 auditime. E veçantë tjetër në këtë proces është se, në qoftë se vitin e kaluar përzgjedhja e dosjeve të auditimit u bë nga Drejtoria Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, këtë vit ato u përzgjedhën nga vetë audituesit që u angazhuan në procesin e shqyrtimit. Fakti që në këtë proces u aktivizuan auditues të cilët nuk kishin marrë pjesë vitin e kaluar, i shërbeu atyre edhe si proces trainimi, që përvojën e fituar ta reflektojnë në punën audituese të departamenteve ku punojnë.

Gjithashtu vlen për t'u theksuar se miratimi i Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 53, datë 16.04.2012, sollti një hap cilësor në lidhje me kërkesat që shtrohen para audituesve e drejtuesve të departamenteve për arritjen e një niveli të lartë të sigurimit të cilësisë, gjë që reflektohet edhe në rritjen e gjetjeve në krahasim me vitin e kaluar.

Konkluzionet e shqyrtimit të paraqitura më lart sipas departamenteve dhe grupeve të auditimit, janë të trajtuara në materialet konstatues të grupeve të shqyrtimit të cilësisë bashkëlidhur këtij raporti, në vijim të të cilave kërkohet që nga ana e departamenteve të kontrollit të reflektohet në drejtim të zbatimit me rigorozitet të procedurave të përcaktuara në ligjin organik, Rregulloren e Brendshme, Standardet e Kontrollit dhe Manualët e miratuara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË PROCESIN AUDITUES - 2012

IV. REKOMANDIME

Duke vlerësuar performancën e arritur në drejtim të përmirësimit të sigurimit të cilësisë së punës audituese, si dhe duke reflektuar ndaj të metave e mangësive të vërejtura gjatë shqyrtimit të dosjeve të auditimit për kontrollin e sigurimit të cilësisë, për përmirësimin e punës në të ardhmen rekomandojmë:

1. Në zbatim të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH, qëllimi i shqyrtimit për sigurimin e cilësisë së punës audituese është që drejtuesit e lartë të institucionit të marrin siguri të arsyeshme që auditimet janë kryer në përputhje me standardet dhe metodat e miratuara dhe në zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore. Gjithashtu zbatimi i këtij procesi shqyrtimi shtron kërkesa për të identifikuar e pasqyruar objektivist mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, prandaj është detyrë e drejtuesve të departamenteve që konkluzionet e rekomandimet e raportit të sigurimit të cilësisë të trajtohen në analizat e departamenteve dhe të mbahen parasysh në vlerësimin vjetor të punës së kontrollorëve.

2. Kontrolli për sigurimin e cilësisë të mos përqendrohet në një numër të kufizuar dosjesh auditimi në fund të vitit, por të jetë një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit për dosjet e evaduar dhe të arkivuara, ku të shqyrtohen sa më shumë dosje, duke marrë në konsideratë edhe kontrollet që kanë të bëjnë me zbatimin e rekomandimeve të auditimit, pasi nëpërmjet këtyre verifikohet drejtësia e konkluzioneve dhe rekomandimeve të auditimit, tregues këto të cilësisë dhe efektivitetit të punës audituese. Një praktike e këtillë filloi të aplikohet gjatë vitit 2012, por këtë vit duhet të shtrihet në një numër më të madh auditimesh, proces të cilin e favorizon edhe miratimi i rregullores së re. Për këtë qëllim kërkohet që krahas fuqizimit të strukturës së kontrollit të sigurimit të cilësisë me specialistë të emëruar në këtë funksion apo duke aktivizuar rast pas rasti auditues nga departamentet e auditimit, të punohet edhe për hartimin e manualit përkatës për këtë qëllim.

3. Me qëllim përmirësimin e paraqitjes sa më cilësore të materialeve të auditimit dhe evitimit të problematikave të hasura gjatë zbatimit të saj, duhet të përmirësohet Rregullorja e Brendshme si dhe të plotësohen Formularët Standarde. Gjithashtu, në zbatim të Rregullores së Brendshme dhe në funksion të grupeve të auditimit dhe përmirësimit të cilësisë duhet të vendoset dhe një jurist stabil në Departamentet e Auditimit, i cili duhet të japë dhe mendimin e tij paraprak në lidhje me auditimin krahas kryeaudituesit drejtorit të departamentit.

**Grupi për shqyrtimin
e Sigurimit të Cilësisë**

DREJTOR

Bashkim SPAHIJA

Ermal YZEIRAJ

Albana PENGILI

SHKURT 2013